

Paradhënie bankare me garanci monetare (OD Cash Collateral)

Informacion rreth Bankës

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr "Ismail Qemali", Nr. 27,
Kutia postare 8319
1001 Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762
Website: www.intesasanpaolobank.al

Karakteristikat dhe rreziqet e Paradhënie bankare me garanci monetare "OD Cash Colateral"

Karakteristikat e "OD Cash Colateral"

Paradhënia e garantuar me cash (para fizike) është përdorimi i përkohshëm i kredisë nga një klient, kur ka fonde të pamjaftueshme në llogarinë e tij/. Kjo kredi u vihet në dispozicion klientëve individë për një periudhë afat-shkurtër për të plotësuar nevojat e tyre për likuiditet në monedhën EUR/ USD/ LEK, e cila do të jetë e njejtë ose e ndryshme nga monedha e depozitës që do të vendoset si kolateral. Si kolateral do të shërbejë cash i vendosur në ISBA në formën e Depozitës me Afat, Llogarisë Rrjedhëse, Llogarisë së Kursimit apo cdo produkt depozite apo llogarie e ofruar nga ISBA si dhe Letra me Vlerë/ Bono Thesari. Kolaterali duhet të jetë në emër të klientit (huamarrësit) i cili po aplikon për paradhënien dhe/ose ndonjë klient tjetër i cili do të bllokojë kolateralin në cash/letra me vlerë në emër të huamarrësit. Raporti i mbulimit për linjën paradhënies në cash/letra me vlerë, duhet të jetë:

- 110% nëse kolaterali dhe ekspozimi janë në të njëjtën monedhë
- 120% nëse kolaterali dhe ekspozimi janë në monedha të ndryshme

Tregu i synuar

Klientët e bankës të cilët kanë fondet e tyre në formën e depozitës me afat, llogarisë rrjedhëse, llogari kursimi, ose bono thesari dhe që përballen me një nevojë të papritur për likuiditet.

Opsione të tjera shtesë

Klienti mund të përdorë paradhënien sipas diskrecionit të tij për çdo qëllim. Edhe nëse klienti nuk e përdor menjëherë atë, ai e ka paradhënien të vlefshme në llogarinë e tij dhe mund ta përdorë atë në çdo kohë, për çdo situatë dhe ngjarje të paparashikuar (24 orë në ditë/ 365 ditë në vit nëpërmjet Kartës së Debitit). Klienti mund të kursejë depozitën për nevojat e ardhshme duke parandaluar rrezikun e kursit të kembimit.

Dokumentet e nevojshme

1. Kopje e dokumentit të vlefshëm të identifikimit;
2. Kopje e dokumentit të T/D, TBill, Current/Savings account e cila do të shërbejë si garanci
3. Të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Kredisë

Shërbime suplementare

Shërbimi suplementar që ofrohet së bashku me Paradhënien e garantuar me cash (para fizike) është llogaria rrjedhëse e cila mund të përdoret për të gjitha transaksionet e tjera operationale, si edhe një kartë debiti për të garantuar që klienti ka akses të shumës së dhënë çdo 24 orë.

Rreziqet e "OD Cash Colateral"

Nëse kredia është dhënë në Eur/USD dhe të ardhurat e klientit janë në lekë, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e kursit të këmbimit.

Struktura e çmimit:

Interesi vjetor që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Bankës aplikohet me baza vjetore dhe metoda e llogaritjes është numri i ditëve/360. Norma e Interesit Vjetor është një kuote fikse dhe e pandryshueshme.

Interesi vjetor që Kredimarrësi detyrohet t'i paguajë Bankës aplikohet me baza vjetore dhe metoda e llogaritjes është numri i ditëve/360 . Interesi përllogaritet cdo ditë mbi shumën e përdorur të 'Principalit' të rezultuar në fund të cdo dite dhe paguhet cdo muaj në datën e pare të punës së muajit pasardhës.

Norma Vjetore Fikse e Interesit

Nënkupton një kuotë fikse e cila do të përbëjë 'Normën Vjetore të Interesit' për periudha të caktuara përgjatë kohëzgjatjes së Kontratës së Kredisë

Norma vjetore e Interesit (NI)

Norma e interesit vjetor përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- a) një kuotë e caktuar fikse dhe e pandryshueshme si dhe
- b) norma bazë e interesit, e cila është një kuotë e ndryshueshme, barabartë me normën e interesit te depozitës me afat.

"Norma Minimale e Interesit" (NMI)

NMI do të thotë vlera më e ulët vjetore, nën të cilën 'Norma Vjetore e Interesit' nuk do të llogaritet në asnjë rast, megjithëse si rezultat i ndryshimeve të 'Normës Bazë të Interesit', 'Norma vjetore e interesit' do të rezultojë në një vlerë më të ulët (për shkak të aplikimit të formulës: Norma Bazë e Interesit + Marzhin).

Norma vjetore e interesit do të jetë e barabartë me normë më të lartë vjetore midis Normës së Interesit (NI) dhe Normës Minimale të Interesit (NMI).

| OD Cash Colateral | NI |
|----------------------------------|---|
| Norma vjetore e interesit ne EUR | Norma e interesit të Depozitës me Afat + 2%; NMI 3.25% |
| Norma vjetore e interesit ne LEK | Norma e interesit të Depozitës me Afat + 2%; NMI 3.25% |
| Norma vjetore e interesit ne USD | Norma e interesit të Depozitës me Afat + 2%; NMI 3.25% |

Shembull ilustrativ për llogaritjen e kështit të kredisë

Nëse klienti do të aplikojë për shumën e paradhënies prej LEK 1,000,000, për një afat 1 vit dhe duke supozuar një normë interesi 4.5 %, do të paguajë totalin e Interesit LEK 45,000.

| | |
|--------------------------------|---------------|
| Shuma e kredisë se përdorur | 1,000,000 LEK |
| Afati | 1 Vit |
| Norma vjetore e interesit | 4.5% |
| Totali i interesave te paguara | 45,000 LEK |
| Totali i kredisë/kësteve | 1,045,000 LEK |
| Komisioni administrimit | 4,000 LEK |

**Shembulli i Personalizuar dhe vlerat e sipërpërmendura kane karakter ilustrativ dhe prezumojne perdorimin e te gjithë shumes pergjate gjithe kohezgjatjes se kredisë, dhe do te ndryshojne ne varesi te shumes se kredisë se përdorur nga Kredimarrësi dhe kohezgjatjes se përdorimit*

Karakteristikat

Shuma minimale USD 400 / LEK 55,000 / EUR

400 / Afati deri në 1 Vit

 Shuma maksimale 90% të garancisë monetare të përdorur si kolateral (nëse kolaterali dhe ekspozimi i kredisë janë në të njëjtën monedhë)
 80% të garancisë monetare të përdorur si kolateral (nëse kolaterali dhe ekspozimi i kredisë janë në monedha të ndryshme)

Afati deri në 1 Vit

Kamatëvonesë 10%

Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës dhe menaxhimin e marrëdhënies kontraktore
Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës

| | |
|-------------------------|-------|
| Aktivitetet paraprake | N/A |
| Vlerësimi teknik | N/A |
| Pagesa të tjera: | N/A |
| Komisioni i parapagimit | Falas |

Kostot dhe shpenzimet për menaxhimin e marrëdhënies kontraktore

| | |
|---|--|
| Komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë së OD Cash Colateral | Sipas kushteve të punës për Individë |
| Komisioni i administrimit | 1.5 o/oo , min EUR 30 max EUR 800 1.5 o/oo , min LEK 4,000 max LEK 112,000 1.5 o/oo , min USD 40 max USD 800 |
| Kostot e komunikimit: | |
| Kosto e komunikimeve ligjore shkresore | Falas |
| Kosto e komunikimeve ligjore online | Falas |
| Njoftim me shkrim për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës | Nuk aplikohet |
| Njoftim elektronik (SMS) për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës | 50 Lek (Opsionale, sipas kërkeses se klientit) |
| Amendimi i kontratës së OD Cash Colateral | Falas |
| Lëshimi i konfirmimit bankar | 1,000 Lek |
| Periodiciteti i pagesës së interesit | Çdo muaj |

Ripagimi para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat
Ripagimi para afatit

Klienti mund të ripaguajë kredinë në çdo kohë duke njoftuar Bankën të paktën 15 ditë përpara datës së likuidimit.

Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Çdo ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në Kontratën e Kredisë për Paradhënie Bankare do të jetë efektiv pas miratimit me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e Kredisë për Paradhënie Bankare nuk do të jetë efektiv nëse palët nuk bien dakord me shkrim.

Ankesat

Ankesat mund të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Me shkresë dërguar në Bankë me postë;
- Në degë tek "Kutia e ankesave & sugjerimeve" (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesat me shkrim nëpërmjet llogarisë së email-it në adresën zyrtare të website-it të Bankës si më poshtë: complain@intesasanpaolobank.al
- Nëpërmjet qendrës së thirrjeve telefonie Call Center në numrin: 08006000

Afati kohor për përgjigjen nga ana e Bankës është maksimalisht 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

Fjalorthi i Termave Kryesore

EURIBOR- (Euro Interbank Offered Rate, norma e publikuar në sistemin Thomson Reuters në faqen EURIBOR në orën 13:00 CET. Informacioni për llogaritjen e këtij indeksi ndodhen në website: <http://euribor-ebf.eu>)

Bono Thesari (T-BILL) - do të thotë Interesi i Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove të Thesarit, të emëtuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Informacionet në lidhje me përlllogaritjen mund të gjenden në faqen: www.bankofalbania.org